

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Western Balkans Fashion Group” SHPK**

Sot më date, 22/10/2024 (dy mijë e njëzet e katër), palët e mëposhtme:

- **Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK**, një shoqëri e themeluar dhe e organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me seli në Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga "Papa Gjon Pali II", Ndërtesa nr. 12, Kati 11, Zyra nr. 1100, Kodi Postar 1010, Tiranë, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit K72223031K, përfaqësuar nga Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, në datën 03/02/1983, e identifikuar nga letërnjoftimi me nr. 038523830 dhe me numër personal I35203147R, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e administratorit.
- **Z. Juljan Mane**, shtetas shqiptar lindur më date 15.01.1977, në Korçë, Shqipëri, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H70115065N, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- **Z. Arsim Papraniku**, shtetas maqedonas, lindur më date 18.04.1975, në Shkup, Maqedoni, banues në Bul. Partizanski Odredi, nr. 10/1-5, Shkup, Maqedoni, mbajtës i letërnjoftimit me nr. A0194690, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Të cilët, në përputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe legjislacionit të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet nënshkrimit të këtij Akti Themelimi kanë vendosur të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar “Western Balkans Fashion Group” SHPK. Aktiviteti i kësaj shoqërie do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.

**Neni 1 – Emërtimi dhe Forma e Shoqërisë**

- 1.1 Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “Western Balkans Fashion Group” Sh.p.k (këtej e tutja referuar edhe si “Shoqëria”).
- 1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

**Neni 2 – Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Godina Brunos Space, Qendra Tregtare TEG, përballë hyrjes violë, Rruga Nationale Tiranë – Elbasan, Farkë, Lundër, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të hapë dhe/apo mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri apo jashtë saj.

**Neni 3 – Kohëzgjatja**

- 3.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 3.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 4 – Objekti**

- 4.1 Objekti i aktivitetit ekonomik të Shoqërisë:

- a. Import, shitje me shumicë e pakicë të produkteve tekstile, veshjeve të të gjitha llojeve sipas kontratës franchising me KIABI;
- b. Çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë e që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### **Neni 5 – Kapitali Themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është EUR 100,000 (një qind mijë euro) që i korrespondon një vlere prej 10,000,000 (dhjetë milion lekë) LEK sipas kursit të këmbimit EUR:LEK [1 EURO = 100 LEK].

5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht si në vijim:

- **Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK**, një shoqëri e themeluar dhe e organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me seli në Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga "Papa Gjon Pali II", Ndërtesa nr. 12, Kati 11, Zyra nr. 1206, Kodi Postar 1010, Tiranë, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit K72223031K, ka shlyer 75% (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit me kontribut në para;
- **Z. Juljan Mane**, shtetas shqiptar lindur më date 15.01.1977, në Korçë, Shqipëri, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H70115065N, ka shlyer 10% (dhjetë përqind) të kapitalit me kontribut në para;
- **Z. Arsim Papraniku**, shtetas maqedonas, lindur më date 18.04.1975, në Shkup, Maqedoni, banues në Bul. Partizanski Odredi, nr. 10/1-5, Shkup, Maqedoni, mbajtës i letërnjoftimit me nr. A0194690, ka shlyer 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit me kontribut në para.

5.3 Duke u bazuar në kontributet e mësipërme:

- **Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK** zotëron 1 (një) kuotë e barabartë me 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- **Z. Juljan Mane**, zotëron 1 (një) kuotë e barabartë me 10% (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- **Z. Arsim Papraniku**, zotëron 1 (një) kuotë e barabartë me 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

### **Neni 6 – Transferimi I kuotave**

6.1 Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 8 të Statutit.

### **Neni 7 – Administratori/ët**

7.1 Shoqëria administratohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht përveçse kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim ose dorëheqje ose për një periudhë 3 (tre) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për vitin tjetër.

7.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administratimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr. 9901, date 14 Prill 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.

7.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me procure speciale ("ad negotia") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.

7.4 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i pare i Shoqërisë:

- Z. Redon Sholla, shtetas shqiptar, lindur në Berat, ALB, më 03.06.1984, me banim në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal I40603067F dhe nr. 037487055, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili autorizohet me anë të këtij akti që personalisht ose duke autorizuar persona të tjerë, të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë "Western Balkans Fashion Group" SHPK, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe të regjistrojnë Shoqërinë pranë autoriteteve fiskale, sigurimeve shoqërore dhe çdo dhe të gjitha autoriteteve shqiptare sikurse mund të kërkohet nga ligji i zbatueshëm në fuqi, përfshirë të drejtën për të nënshkruar aktet dhe dokumentet përkatëse në këto organe.

### Neni 8 - Gjuha

8.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

### Neni 9 - Dispozitat e fundit

9.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjisllacionit shqiptar.

Për

**Balfin - Balkan Finance Investment Group**

**Z. Juljan Mane**

Znj. Edlira Muka

Administrator



**Z. Arsim Papraniku**